

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr 1, Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

“RIPARIM I MAKINAVE QEPËSE”

KODI: RMQ-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“RIPARIM I MAKINAVE QEPESE”

(KODI: RMQ-20)

I. Profili Profesional i “Riparuesit të makinave qepëse”.

a) Karakteristikat e “Riparuesit të makinave qepëse”.

Riparuesi i makinave qepëse është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në ndërmarrje të rrobaqepsisë, apo si i vetëpunësuar për riparimin dhe montimin e makinave qepëse.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, Riparuesi i makinave qepëse duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë për zmontimin dhe montimin e makinave qepëse familjare dhe qepëse industriale, të përcaktimit të defekteve dhe riparimit të tyre, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e riparimit të makinave qepëse.

Suksesi i Riparuesit të makinave qepëse është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, korrektësia, disiplina, etika e komunikimit etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e “Riparuesit të makinave qepëse”.

Profesioni i Riparuesit të makinave qepëse është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për diagnostikim e defekteve dhe riparimin e tyre. Ai mund të punësohet në fabrika dhe reparte rrobaqepsie, ose mund të vetëpunësohet si riparues i makinave qepëse.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e Riparuesit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një riparues i makinave qepëse mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit mekanik. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën riparimit të makinave qepëse dhe shërbimeve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Riparim i makinave qepëse”

Në përfundim të Kursit për “**Riparim i makinave qepëse**” kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik të makinave qepëse familjare dhe industriale të tegelit të drejtë;
- përdorin udhëzues, katalogë, manuale për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave qepëse industriale;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, instrumentat, dhe materialet e duhura të punës për riparimin e makinave qepëse;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet në mjedisin e punës;
- zmontojnë-montojnë makinën qepëse familjare;
- vendosin në fazë makinën qepëse familjare;
- realizojnë diagnostikimin dhe riparimin e defektet që lindin gjatë proceseve të punës në makinat qepëse;
- zmontojnë-montojnë makina industriale të tegelit të drejtë;

- realizojnë diagnostikimin dhe riparimin e defektet që lindin gjatë procesve të punës në makinën qepëse industriale të tegeli të drejtë;
- rregjistrojnë lëvizjet kryesore në makinën industriale të tegelit të drejtë;
- kontrollojnë për lëvizjet e frenuara makinën industriale të tegelit të drejtë;
- riparojnë kasat në makinën industriale të tegelit të drejtë me kasë të lëvizëshme;
- zmontojnë-montojnë makina qepëse zig- zag;
- realizojnë diagnostikimin dhe riparimin e defektet që lindin gjatë procesve të punës në makinat qepëse zig –zag;
- zmontojnë-montojnë makinën syzator;
- rregjistrojnë lëvizjet kryesore në makinën syzator;
- realizojnë diagnostikimin dhe riparimin e defekteve në makinën syzator;
- zmontojnë –montojnë makinën hekurosëse elektrike;
- realizojnë diagnostikimin dhe riparimin e defektet në hekurin hekurosës dhe tavolinën e hekurosjes;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të makinave qepëse;
- zbatojnë legjislacionin e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Riparim i makinave qepëse”

Pjesëmarrësit në Kursin “**Riparim i makinave qepëse**” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Riparim i makinave qepëse”

340 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Riparim i makinave qepëse”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e riparuesit të makinave qepëse.	RMQ-01-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit të makinave qepëse. 2. Kursanti përshkruan makinat qepëse familjare dhe industriale të tegelit të drejtë. 3. Kursanti përshkruan defektet kryesore në makinat qepëse familjare, industriale të tegelit të drejtë. 4. Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

2	Riparime në makinat qepëse familjare.	RMQ-02-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zmonton - monton makinën qepëse familjare. 2. Kursanti vendos në fazë makinën qepëse familjare. 3. Kursanti kryen punime në kasën e palëvizëshme në makinën qepëse familjare.
3	Riparime në makinat qepëse industriale të tegelit të drejtë.	RMQ-03-20	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zmonton - monton makina qepëse industriale të tegelit të drejtë. 2. Kursanti kryen regjistrimin e lëvizjeve kryesore në makinën industriale të tegelit të drejtë. 3. Kursanti kontrollon për lëvizjet e frenuara makinën industriale të tegelit të drejtë. 4. Kursanti kryen riparime të defekteve në makinën industriale të tegelit të drejtë. 5. Kursanti kryen riparimin e kasave në makinën industriale të tegelit të drejtë me kasë të lëvizëshme.
4	Riparime në makinat zig – zag.	RMQ-04-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zmonton - monton makinat zig - zag. 2. Kursanti kryen riparime në makinat zig-zag.
5	Riparime në makina qepëse syzator.	RMQ-05-20	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zmonton - monton makinën syzator. 2. Kursanti kryen regjistrimin e lëvizjeve kryesore në makinën syzator . 3. Kursanti riparon defektet në makinën syzator.
6	Riparime në makinat hekurosëse elektrike.	RMQ-06-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zmonton - monton makinën hekurosëse elektrike. 2. Kursanti riparon defektet e hekurit hekurosës. 3. Kursanti riparon defektet e tavolinës së hekurosjes.

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Riparimi i makinave qepëse”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e riparuesit të makinave qepëse.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E RIPARUESIT TË MAKINAVE QEPËSE.	RMQ-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të riparuesit të makinave qepëse për përdorim shtëpiak dhe industrial, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë e tij, si dhe me rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit të makinave qepëse. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së riparuesit të makinave qepëse; - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës; - të përshkruajë veglat, pajisjet, instrumentet që përdor tekniku i makinave qepëse; - të përshkruajë kërkesat profesionale të riparuesit të makinave qepëse ; - të tregojë mundësitë e punësimit; - të përshkruajë kërkesat ligjore të veprimtarisë së riparuesit për riparimin e makinave qepëse; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan makinat qepëse familjare dhe industriale të tegelit të drejtë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e makinave qepëse familjare dhe industriale;
- të përshkruajë llojet e metaleve të makinave qepëse giz, çelik etj.;
- të përshkruajë mekanizmat e ndryshëm dhe nyjet e detaleve;
- të përshkruajë boshtet, akset dhe kuzhinetat;
- të listojë pjesët përbërëse të makinave qepëse për përdorim shtëpiake ,funksionet dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e makines qepëse familjare;
- të përshkruajë llojet ndërtimin dhe pjesët përbërëse të makinës qepëse industriale;
- të përshkruajë makinat qepese zig-zag dhe syzator;
- të përshkruajë akset, boshtet dhe elementet e tyre;
- të klasifikojë kuzhinetat në varësi të forcave që ato mbajnë;
- të përshkruajë transmisionet kanike;
- të përshkruajë trasmissionet me rrota të dhëmbëzuara;
- të përshkruajë filetat, tipet dhe elementët e lidhjeve me to;
- të përshkruajë mekanizmat për kthimin e lëvizjeve rrotulluese në lëvizje drejtëvizore;
- të përshkruajë mekanizmin bjellë-manivel, mekanizmin me kremaline, me vidhe dhe dado dhe mekanizmat me gunga;
- të listojë mekanizmat tipike të makinave, funksionet dhe përdorimet e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan defektet kryesore në makinat qepëse familjare, industriale të tegelit të drejtë .

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë defektet kryesore të makinave qepëse dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet kryesore të makinave qepëse familjare dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet kryesore të makinave qepëse industriale dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet kryesore të makinave qepëse zig-zag dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet kryesore të makinave qepëse syzator dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet kryesore të trasmissioneve mekanike dhe atyre me rrota të dhëmbëzuara dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet e kuzhinetave në varesi të forcave që ato mbajnë dhe shkaqet e tyre;

- të përshkruajë defektet e elementeve në lidhjeve me filetot.
- të përshkruajë defektet kryesore të mekanizmave të ndyshme në makinat qepëse dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defekte në kasën e lëvizshme, në folenë e masurit, gjilpërës me faqe dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet që shkaktohen nga mbledhja e perit në masur dhe rregullatori dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet e rregullatorit të kmbëzës dhe shkaqet e tyre;
- të përshkruajë defektet në boshtet kryesore dhe volante dhe shkaqet e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë;
- të dallojë dhe shpjegojë masat e mbrojtjes në mjediset e punës për shërbime në makinat qepëse;
- të shpjegojë rëndësinë dhe përbërjen e kutisë së ndihmës së parë;
- të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë;
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve në makinat qepëse industriale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të riparimit të makinave qepëse .
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës.
- Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të Riparuesit të makinave qepëse .
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

	- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në riparim te makinave qepëse . - Komplete veshjesh të ndryshme. - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepëse . - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

\

2. Moduli “Riparime në makinat qepëse familjare”

PERSHKRUESI I MODULIT			
Titulli dhe kodi	RIPARIME NË MAKINAT QEPËSE FAMILJARE		RMQ-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët me procesin e zmontimit - montimit të makinës qepëse familjare, riparimin e kasës së palëvizëshme dhe vënien në fazë të makinës së thjeshtë familjare.		
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime		
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparuesit të makinave qepëse”		
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti zmonton - monton makinën qepëse familjare. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë ndërtimin e makinës qepëse familjare; - të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit dhe të montimit të makinës qepëse familjare; - të organizojë vendin e punës për zmontimin dhe montimin e makinës qepëse familjare; - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për zmontimin dhe montimin e makinës qepëse familjare; - të kryejë zmontimim - montimin e makinës qepëse familjare; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vezhëim me liste kontrolli.	
	RM 2	Kursanti vendos në fazë makinën qepëse familjare. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë procesin e vënies në fazë të makinës qepëse familjare; - të përshkruajë kombinimin e 5 lëvizjeve në makinën qepëse familjare; - të kryejë riparime – zevëndësime të pjesëve të dëmtuara të makinës qepëse familjare;	

- të kryejë fazimin e makinës;
- të kryejë fazimin vertikal-horizontal të kasës me gjilpërën;
- të kryejë fazimin e transportit të materialit që qepet;
- të kryejë fazimin e koordinuar të tërheqësit të perit me transportierin;
- të kryejë kombinimin e 5 lëvizjeve kryesore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.3 Kursanti kryen punime në kasën e palëvizëshme në makinën qepëse familjare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë e kasës së palëvizëshme në makinën e thjeshtë familjare;
- të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit-montimit të kasës në makinën e thjeshtë familjare;
- të organizojë vendin e punës për zmontimin dhe montimin e kasës së palëvizëshme në makinën e thjeshtë familjare;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet, e duhura për zmontimin dhe montimin e kasës në makinën e thjeshtë familjare;
- të kryejë vendosjen e gjilpërës;
- të kryejë regjistrimin e perit të poshtëm (dru masur);
- të kryejë regjistrimin e perit të sipërm (grupi i të nsionit të perit të sipërm);
- të kryejë përshtatjen e makinës me copën që qepet;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen riparime të makinave qepëse.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit të defekteve të ndryshme.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, përvendosjen dhe kryerjen e regjistrimeve të thikave dhe këmbës së shtypjes në kasën e makinave të drejtë familjare fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

	- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në riparim te makinave qepese. - Komplete veshjesh të ndryshme. - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepese. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Riparime në makinat qepëse industriale të tegelit të drejtë”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RIPARIME NË MAKINAT QEPËSE INDUSTRIALE TË TEGELIT TË DREJTË.	RMQ-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët me proceset e zmontim - montimit të makinave qepëse industriale të tegelit të drejtë si dhe të kryejnë riparime të pjesëve përbërëse si dhe zëvendësime në rastet e nevojshme të pjesëve të dëmtuara.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e riparuesit të makinave qepëse ” dhe “Riparime në makina qepëse familjare”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti zmonton - monton makina qepëse industriale të tegelit të drejtë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet dhe llojet e makinave industriale; - të përshkruajë ndërtimin e makinës qepëse industriale të tegelit të drejtë;

-
- të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit dhe të montimit të makinës qepëse industriale të tegelit të drejtë;
 - të organizojë vëndin e punës për zmontimin dhe montimin e makinës qepëse industriale të tegelit të drejtë;
 - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për zmontimin dhe montimin e makinës industriale të tegelit të drejtë;
 - të kryejë zmontimin-montimin e makinës qepëse industriale të tegelit të drejtë;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen regjistrimin e lëvizjeve kryesore në makinën industriale të tegelit të drejtë .

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e regjistrimit të 5 lëvizjeve kryesore në makinën industriale të tegelit të drejtë;
- të kryejë regjistrimin e 5 lëvizjeve kryesore në makinën industriale të tegelit të drejtë;
- të kryejë regjistrimin e transportierit të materialit;
- të kryejë regjistrimin e frenimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kontrollon për lëvizjet e frenuara makinën industriale të tegelit të drejtë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë e lëvizjeve të frenuara në makinën industriale të tegelit të drejtë;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet, dhe materialet e duhura për të kryer kontrollin;
- të kryejë vajisjen e makinës industriale të tegelit të drejtë;
- të kryejë pastrimin e makinës industriale të tegelit të drejtë;
- të evitojë mledhjen e perit në nyjen e makinës;
- të regjistrojë forcat që kryejnë transportin e materialit;
- të regjistrojë forcat shtypese të këmbëzës me forcën shtypese të transportierit (dhëmbëzat);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vezhë me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen riparime të defekteve në makinën industriale të tegelit të drejtë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të diagnostifikojë defektet në makinën industriale të tegelit të drejtë;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet, dhe materialet e duhura për të kryer riparime;
- të kryejë riparime dhe zëvendësime të pjesëve të dëmtuara
- të kryejë ndërrimin e gjilpërës;
- të kryejë regjistrimin vertikal-horizontal të gjilpërës me kasën;
- të ndërrojë kasën në rast të konsumit të saj;
- të pastrojë gërvishtjet e kalesave të perit;
- të rregjistrojë rregullatorin e perit të sipërm;
- të pastrojë vrimën e gjilpërës në pllakë;
- të kryejë zëvendësimin e pllakës së gjilpërës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vezhë me listë kontrolli.

RM.5 Kursanti kryen riparimin e kasave në makinën industriale të tegelit të drejtë me kasë të lëvizëshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndërtimin e kasës sipas llojit në makinat qepëse industriale;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet, dhe materialet e duhura për të kryer riparime dhe zëvendësime të pjesëve të dëmtuara;
- të kryejë regjistrimin e frerit të kasës dhe nivelit të transportit;
- të kryejë vendosjen e grupit të hapit të transportit para dhe indietro dhe regjistrimin në fazë;
- të kryejë transportin e materialit nga dhëmbët tërheqës;
- të ndërrojë dhe rregjistrojë sustat tërheqëse dhe shtytëse;
- të vendosë rripat me dhëmbë brenda fazës;
- të kryejë vendosjen e thikave në pozicionin e duhur;
- të kryejë regjistrimin në fazë të prerjes;
- të tregojë ndërtimin e elektromotorrit;
- të vendosë kondensatorin në rrjetin elektrik të motorrit nga tre fazor në monofazë;

- të montojë paketën elektronike të tipit varistop;
- të kryejë lidhje direkte të motorit me linjën e korentit;
- të kryejë kontrolle të lëvizjeve të grupit të thikave;
- të shmangë defektet që mund të shkaktohen nga levizja e grupit të thikave;
- të kryejë kontrolle të lëvizjeve të këmbës së shtypjes;
- të shmangë defektet që shkaktojnë levizjët e këmbës së shtypjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen riparime të makinave qepëse industriale. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit të defekteve të ndryshme. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, për kryerjen e rregjistrimeve të nevojshme, kontrollit, riparimit apo zëvendësimit të pjesëve në makinat qepëse fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjediset reale të punës në riparim të makinave qepëse. - Komplete veshjesh të ndryshme. - Kompletet e materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepëse. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materialet të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Riparime në makinat zig - zag”

PERSHKRUESI I MODULIT			
Titulli dhe kodi	RIPARIME NË MAKINAT ZIG - ZAG		RMQ-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët me proceset e zmontim- montimit të makinave qepëse industriale speciale zig- zag si dhe të kryejnë riparime të pjesëve dhe zëvendësime në rastet e nevojshme të pjesëve të dëmtuara.		
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime		
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e Riparuesit të makinave qepëse”, “Riparime në makina qepëse familjare’ dhe “Riparime në makinat qepëse industriale të tegelit të drejtë”.		
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti zmonton - monton makinat zig - zag. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet dhe llojet e makinave zig -zag; - të përshkruajë ndërtimin e makinës të tregojë ndërtimin e makines zig-zag; - të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit dhe të montimit të makinës qepëse industriale dhe zig zag; - të organizojë vëndin e punës për zmontimin dhe montimin e makinës makinës qepëse industriale zig -zag; - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për zmontimin dhe montimin e makinës zig -zag; - të kryejë zmontimin-montimin e makinës qepëse zig-zag; - të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Kursanti kryen riparime në makinat zig – zag.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë funksionet e makinave zig –zag;
- të përshkruajë kombinimin e 6 lëvizjeve në makinën qepëse zig-zag;
- të tregojë defektet e shpeshta në makinat zig- zag;
- të diagnostikojë defektet në makinat zig- zag;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet,dhe materialet e duhura për të kryer kontrollin dhe riparimet;
- të kryejë fazimin e makinës zig –zag ;
- të kryejë regjistrimin e lëvizjes zig-zag në makinë;
- të kryejë regjistrimin e 6 lëvizjeve të makines zig-zag;
- të kryejë riparim dhe zëvendësim të pjesëve të dëmtuara;
- të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen riparime të makinave qepëse zig-zag.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit te defekteve te ndryshme.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, për kryerjen e regjistrimeve të nevojshme, kontrollit, riparimin apo zëvendësimit e pjesëve në makinat qepëse zig-zag fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjediset reale të punës në riparim te makinave qepëse.
 - Komplete veshjesh të ndryshme.
 - Komplete i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepese.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materialet të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Riparime në makinat qepëse syzator”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RIPARIME NË MAKINAT QEPËSE SYZATOR	RMQ-05-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët me proceset e zmontim - montimit të makinave qepëse syzator, riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve përbërëse të dëmtuara.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparuesit të makinave qepëse”, “Riparime në makina qepëse familjare”, “Riparime në makinat qepëse industriale të tegelit të drejtë” dhe Riparime në makinat qepëse zigzag”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti zmonton - monton makinën syzator. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë ndertimin, funksionet dhe llojet e makinave syzator; - të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit dhe të montimit të makinës syzator; - të organizojë vendin e punës për zmontimin dhe montimin e makinës makinës syzator; - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për zmontimin dhe montimin e makinës syzator; - të kryejë zmontimin-montimin e makinës syzator; - të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vezhëgjim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti kryen regjistrimin e lëvizjeve kryesore në makinën syzator . Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë e proceve të regjistrimit në makinën syzator; - të kryejë regjistrimin e mekanizmave të brendshëm; - të kryejë regjistrimin e bjellës; - të kryejë regjistrimin e udhëzuesit në formë piruni; - të kryejë regjistrimin e thikës së poshtme; - të kryejë regjistrimin e thikës në rrafshin horizontal; - të kryejë regjistrimin e gjilperës; - të kryejë regjistrimin e ganxhës së poshtme;	

- të kryejë regjistrimin vertikal të gjilpërës me kanxhën e poshtme;
- të kryejë regjistrimin e kanxhës së sipërme;
- të kryejë regjistrimin e transportierit;
- të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti riparon defektet në makinën syzator .

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të identifikojë defektet gjatë qepjes dhe shkaqet e tyre;
- të riparojë kanxhën e poshtme për të shmangur këputjen e perit;
- të riparojë defektin e lënies së pontit;
- të kryejë riparimin e thyerjen e gjilpërës;
- të kryejë rregullimin e tegelit nëpërmjet rregullatorëve përkatës;
- të kryejë vajisjen e makinës syzator;
- të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen riparime të makinave qepëse industriale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit të defekteve të ndryshme.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, përvendosjen dhe kryerjen e regjistrimeve të thikave dhe këmbës së shtypjes fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

**e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në riparim te makinave qepëse.
 - Komplete veshjesh të ndryshme.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepese.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Riparime në makinat hekurosëse elektrike”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RIPARIME NË MAKINAT HEKUROSESË ELEKTRIKE	RMQ-06-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët me proceset e zmontim- montimit të makinave hekurosëse elektrike dhe riparimit të defekteve në hekur dhe tavolinat hekurosëse.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e teknikut të makinave qepëse”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti zmonton - monton makinën hekurosëse elektrike. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë ndertimin, funksionet dhe llojet e makinave hekurosëse elektrike; - të përcaktojë saktë rrugën e zmontimit dhe të montimit të makinës hekurosëse elektrike; - të organizojë vendin e punës për zmontimin dhe montimin e makinës hekurosëse elektrike ; - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për zmontimin dhe montimin e makinës hekurosëse elektrike; - të kryejë zmontimin-montimin e makinës hekurosëse elektrike; - të mirëmbajë pajisjet dhe veglat e punës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vezhë me listë kontrolli. RM 2 Kursanti riparon defektet e hekurit hekurosës. Kriteret e vlerësimit: Kursanti jetë i aftë: - të përshkruajë defektet e zakonshme të hekurit hekurosës; - të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për riparim; - të riparojë termostatin e hekurit; - të riparojë celesin e rrugës së avullit; - të kryejë ndërrimin e rezistencës; - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.3 Kursanti riparon defektet e tavolinës së hekurosjes.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë defektet e zakonshme të tavolinës së hekurosjes;
- të për zgjedhë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e duhura për riparim;
- të kryejë ndërrimin e rezistencës së tavolinës së hekurosjes;
- të riparojë termostatin e tavolinës së hekurosjes;
- të riparojë rezistencën e kaldajës;
- të riparojë presostatin e kaldajës;
- të riparojë galixhantën e nivelit të ujit;
- të riparojë tubacionet e kalimit të ujit dhe avullit;
- të mirëmbajë paisjet dhe veglat e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repart ose mjedise pune ku kryhen riparime të makinave qepëse industriale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe riparimit të defekteve të ndryshme.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, riparimin e defekteve në makinat hekurosëse fillimisht në mënyrë të mbikqyrur, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës.
 - Komplete veshjesh të ndryshme.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në riparimin e makinave qepëse.
-

-
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-